



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Komunitete
Z./Znj. _____

Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Qeverisje Lokale dhe nenit 42 të Statutit të Komunës së Novobërdës:

F T O J

Mbledhjen e parë të Komitetit për Komunitete e cila do të mbahet më **16.01.2019** (e mërkure) duke filluar në orën **10:00**.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Diskutim rreth mirëmbajtjes dimërore të rrugëve lokale;
3. Të ndryshme;

Me: 10.01.2019
Në: Novobërdë



Shpresa Kqiku
Kryesuese e Komitetit për Komunitete



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tetë e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 13.12.2018, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Komitetit për komunitete Shpresa Kqiku, Anëtarët e Komitetit: Dobrivoje Djordjevic, Aleksander Pavic, Jorgovanka Filic, Abdyl Gashi, Behare Jashari, Zyrtari Komunal për Kthim dhe Komunitete, Nënkyetari i Komunës Sinisa Dimic, Nënkyetari për Komunitete Bajrush Ymeri.

Kryesuesja e Komitetit pasi përshendeti të pranishmit tha: e hapi mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Diskutim rreth rasteve të fundit të vjedhjeve në teritorin e Komunës;
3. Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve;
4. Të ndryshme;

Kryesuesja i pyeti se a kan ndonjë propozim apo pajtohen me këtë rend ditë?

Aleksander Pavic pasi përshendeti të pranishmit tha: më intereson të dij të pika e trete se a keni pranuar ndonjë ankesë më shkrime dhe kishte qenë më mirë që ti kemi me material, ju faleminderit.

Kryesuesja tha: kemi pasur vetem thirrje telefonike, me shkrim nuk kemi pasur asgjë.

Abdyl Gashi pasi përshendeti të pranishmit tha: faleminderoj Nënkyetarin i cili është bashk me ne në këtë mbledhje, pikat të cilat po i dikutojm vazhdimisht janë shumë të pakata pasi që kemi mundësi me diskutu shumë më shumë si komitet për komunitete, andaj propozoj që bashkarisht dy apo tri pika ti caktojmë prej kësaj mbledhje që të diskutohen në bledhjen e ardhshme si dhe Kryesuesja të ketë parasysh që ka ndonjë kërkesë tjetër të futet që të kemi një rend dite të pakten me disa pika që të mundë të diskutojm, ju faleminderit.

Dobrivoje Djordjevic pasi përshendeti të pranishmit tha: e pyes Kryesuesen pasi që në mbledhjen e kaluar kanë qenë OSBE-ja dhe disa zyrtarë të qeverisë angleze dhe ata kanë deklaruar se do të marrin pjesë në mbledhje të komitetit andaj ju pyes se a ju keni dërguar ftesë?, ju faleminderit.

Kryesuesja tha: po ju është dërguar.

Pasi nuk pat diskutime tjera aprovohet njëzëri rendi i ditës nga anrët prezent.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;

Kryesuesja tha: për disa arsye teknike procesverbali në gjuhen serbe nuk ka arritur me kohë dhe besoj që do ta keni brenda dy apo tri ditëve andaj në mbledhjen e ardhshme do ti aprovojim të dy procesverbalet.

Pika e dytë: Diskutim rreth rasteve të fundit të vjedhjeve në teritorin e Komunës;

Kryesuesja tha: sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës ju e dini që para disa ditëve kan ndodhë një numër i madhë i vjedhjeve në teritorin e Komunës sonë, së pari ndodhi në fshatin Kufc dhe Stanishorë ku u vodhen disa kafshë dhe një automjet po ashtu, por ajo që është më e keqja janë shqetësuar banorët tonë. Ne e mbajtem një Kuvend të jashtzakonshëm ku u diskutua mjaft nga të gjithë për këtë ngjarje që ka ndodhë, poashtu aty në mbledhje morën pjesë edhe qytetarët që kanë qenë të dëmtuar. U propozuan disa masa por duket se mbeten veq në letër sepse nuk u ndërmor asgjë dhe si rezultat i kësaj vjedhja u përsërit pas disa ditëve dhe në të njëjtat fshatra në Kufc dhe në Stanishorë. Çak i sulmeve këtë rast përveq banorëve ishte edhe kisha e fshatit. Poashtu gjatë javës së kaluar ndodhi edhe një vjedhje në fshatin Tullarë ku familjes së Besnik Musatafës ju vodhën 5 viqa në shtallën e tijë. Pra për një periudhë kaq të shkurtër kohore prej dy muajve të ndodhin gjithë këto vjedhje kjo kërkon angazhim më të madhë të forcat të rendit për të zbardhur këto akte të rënda që po ndodhin në Komunën tonë. Prandaj unë hapë diskutimin rreth kësaj qështje dhe në fund do të dalim me propozime konkrete për disa masa që duhet ndërmarr.

Nenkryetari për Komunitete Bajrush Ymeri pasi përshëndeti të pranishmit tha: atë që e that është diçka për të cilin veç se jemi të njoftuar, vërtet kanë qenë shqetësuese këto ngjarjet të cilat kanë ndodhur pasi që përveq dëmëve materiale të cilat ju kanë bërë ata janë edhe të shqetësuar dhe atë që e kam thënë edhe në Kuvendin e jashtëzakonshëm po e përsëris edhe sotë, ne kemi pasur raste të tilla në zona ruarë po asnjëherë në zona urbane siç ka ndodhur në fshatin Kufc në një vendbanim me shumë popullësi dhe natyrishtë kjo është shqetësuese. Ne po kërkojm vazhdimishtë të ndërmirren masa në këto qështje por rezultate nuk po kemi, ka që disa vite që po kërkojm rritjen e numrit të policisë por askush nuk na dëgjon. E di se edhe në Kuvendin e jashtëzakonshëm ka dal si kërkesë me ju drejtu Ministrisë së Punëve të Brendshme për shtimin e numrit të policëve. Prandaj unë kërkoj edhe sot që çdo Kuvend të përsëritet kjo kërkesë e jona, pasi që kjo nuk do të ndërprehet, për një periudhë aq të shkurtër siç tha edhe Kryesuesja ndodhën këto raste dhe tani është një qetësi pas rastit të fundit por kjo prap do të përsëritet dhe ende nuk është zbuluar askushë. Prandaj përderisa e kemi këtë situatë është mirë që edhe në Kuvend edhe në Komitete të kërkohej shtimi i numrit të policëve dhe pastaj të kërkohej llogari edhe prej policisë, ju faleminderit.

Dobrivoje Djordjevic tha: po ndërlidhem me këtë diskutim, dje e kam pasur një bisedë joformale dhe ata e kanë pregaditur një propozim që stacioni policor nga niveli B të kalojë në nivelin C dhe ata e kanë një ide që të ndërtojnë një stacion dhe si propozim e kanë në fshatin Stanishor, Llabjan ose Bostan dhe në Kuvendin e radhës do të kërkojnë ndarjen e një parcele për këtë ndërtim, stacioni në Novobërdë do të mbetet nënstation me këtë numër të policëve ndërsa stacioni i ri do të veçohet me numër të ri të policëve, ju faleminderit.

Abdyl Gashi tha: mendoj se Komuna jonë gjendet në një gjendje emergjente, ku vjedhjet e fundit janë bërë javore, ditore. Mendoj se edhe Kryetari i Komunës do të silltet në mënyrë më të përgjegjshme për të marrë masat e duhura dhe për të krijuar një bashkëpunim më të mirë me rajonin e Komunës tonë por edhe më gjerë. E dini se shumë njerzë kanë humbur jetën duke mbrojtur pasurinë e tyre, e dini se Komuna jonë është Komunë rurale dhe se shumica mirren me bujqësi dhe blektori dhe se shumica të ardhurat e tyre i sigurojnë përmes bujqësisë dhe ata të nihen të pasigurt që 8 apo 10 vite dhe akoma askush nuk e merr përgjegjësinë që të dalin para drejtësisë kryesore e veprave, nuk mendoj se duhet një ekip shumë i madhë por këtu duhet një polici e pavarur e cila kryen hetime të pavarura të krijoj bashkëpunim me qytetarët, ju faleminderit.

Nenkryetari i Komunës Sinisa Dimic pasi përshëndeti të pranishmit tha: kjo qështje është një qështje që po e bisedojm me vite të tëra, aq shumë e kemi diskutuar sa që kemi hyrë edhe në detale të planeve aksionale të policisë, çdo njërit kur i ka ndodhur ndonjë rast që e ka humbur pasurinë të gjitha ju kanë drejtuar policisë, Komunës dhe organeve tjera. Raste të vjedhjeve kemi pasur edhe në zona urbane dhe

kemi parë nga videokamerat të cilat i kanë regjistruar këto raste se hajnat shetisin sikur janë duke shkuar për të pirë kafe e jo për të bërë krim. Është përmendur që të dhëjmë një tokë në shfrytëzim për ndërtimin e një stacioni të ri të policisë, ne do të jemi bashkpunues vetëm po e presim kërkesën, vendin dhe hapsirën e tokës. Që stacioni i policisë të kalojë prej kategorisë C në B janë disa kushte që duhet plotësuar për të kaluar në atë kategori, e momentalisht në bazë të ligjeve në fuqi Komuna e Novobërdë i plotëson të gjitha kushtet që të kalojë prej kategorisë C në B. Para disa ditëve e kemi përgaditur kërkesën dhe e kemi dërguar në Ministri ja kemi dërguar zyrës së Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Brendshme, poashtu kemi kërkuar që stacioni i Policisë të ketë një bashkpunim më të madhë me stacionin regional të Gjilanit. Gjithashtu kemi kërkuar nga qytetarët që të jenë më të kujdesshëm dhe të bashkëpunojnë me policinë, ju faleminderit.

Abdyl Gashi tha: e kam një pyetje për Nënkryetarin e Komunës, përderisa egzistojnë video a janë marrë këto ingjizime prej stacionit të Policisë?

Sinisa Dimic tha: çdo ingjizim që janë përfshi edhe hajnat edhe automjetet e tyre policia i ka në dorë dhe besoj se është duku punuar në bazë të këtyre ingjizimeve.

Abdyl Gashi tha: përvoja na tregon se kemi pasur edhe më herët kësi lloj ingjizime dhe nuk kanë bërë asnjë veprim.

Sinisa Dimic tha: kur po i përmendim këto ingjizime njerzit shihen si hije, shihet automjeti që kalon shumë shpejt por nuk vrehen tabelat, vetëm shihet se sa njerz kanë qenë, ne cilat shtëpi kanë hyrë. Automobili i cili është vjedhur në rastin e fundit është gjetur dhe i është kthyer pronarit.

Dobrivoje Djordjevic tha: po nderlidhem me atë që e tha Nënkryetari, këto kamera të cilat i kanë vendosur bizneset private më shumë një kamera të ditës, nuk janë kamera që kanë mundësi të bëjnë naten ingjizimin si duhet, pra vetëm duket si hije dhe se sa ka qenë numri i hajnave.

Kryesuesja tha: nese nuk keni më shumë diskutime unë kisha propozu që Kryetari dhe Kuvendi ta themelojnë Këshillin Komunal për siguri në Bashkësi apo siç njihet shkurt si KKSB-ë, të kërkohej nga Drejtoresha e Policisë në Gjilan që ti shtojnë patrollimet gjatë natës në fshatrat që janë afër Gjilanit si në Pasjak, Koretishtë, Stanishor, Kufv dhe Kosaqë, të kërkohej nga Komandanti i Policisë në Novobërdë që të bëjë kërkesë në Ministri për shtimin e numrit të policëve.

Bajrush Ymeri tha: pasi që Nënkryetari na informoj se është bërë kërkesa me shkrim edhe në zyrë të Kryeministrit dhe në konsultim me stacionin policor besoj se më nuk ka më kuptim.

Sinisa Dimic tha: vetëm një informatë ne kemi kërkuar nga Ministra e Punëve të Brendshme që të kalojmë prej kategorisë C në B dhe vet fakti se do të kalojmë në këtë kategori do të dyfishohet numri dhe do të jena polic të fushave të ndryshme dhe njëherit do të kemi logjistiken e nevojshme për ta kryer punën e vetë.

Bajrush Ymeri tha: deri sa të ndodhë kjo merr kohë, andaj deri sa të ndodhë kjo me kërku nga Gjilani që të shtoj numrin e patrollimit në të gjitha fshatrat.

Pika e tretë: Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve;

Kryesuesja tha: sa i përket pikës së tretë që ka të bëjë me kërkesat e qytetarëve, unë kam pasur biseda me qytetarë për disa kërkesa të tyre, është rasti për ndriqim publik në fshatin Llabjan që nuk është duke funksionuar që sa kohë, rregullimi i rrugës së Nexhat Rexhepit në fshatin Terniqevc, qështja e nderprerjes së furnizimit me ujë në fshatin Makresh i ulët. Kërkojmë nga Drejtoria e Sherbimeve publike që të merret më këto probleme për ti sanuar sa më parë.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Bajrush Ymeri tha: kishte qenë mirë që të votohet për ato pika që të shkojnë për diskutim në Kuvend, si formimi i KKSB dhe të tjerat propozime.

Kryesuesja tha: kush është për propozimet e pikes se dytë që të shkojnë dhe të diskutohen në Kuvend. Aprovohen njëzëri këto propozime nga antarët e komitetit për komunitete.

Bajrush Ymeri tha: unë kam pasur shumë telefonata për këto probleme të cilat i përmendi Kryesuesja, ndriqimi në Llabjan ka kushutuar më një shumë të madhe të mjeteve që është bërë nga Komuna, ndoshta ka edhe munges të ndriqimit edhe në vendbanime tjera dhe nuk është duke funksionuar. Qështja e dytë për Nexhat Rexhepin më kanë thirr edhe televizioni, kanë qenë edhe te Kryetari i Komunës, ka bërë kërkesë që një vit me shkrim, kam biseduar me Kryetarin e Komunës dhe Kryetari më ka përkrahur dhe ka thënë se kjo punë do të rregullohet, mirëpo problemi ka qenë të zytari i Sherbimeve Publike Bajram Abazi dhe zytari i prokurimit Goran Zdravkovic, mbi 10 herë ju kam thënë me goj perderisa jam detyraur që para një muaji ti drejtohem edhe me shkrim, a duhet ti drejtohem me shkrim?, natyrisht se jo, është e nenshkrume kontrata për mirëmbajtje të rrugëve, duhet vetem tre kmion me rërë dhe nuk ja shtrojnë rrugën, është detyruar ti thirr mediat për asgjë vetem se menaxherit të kontarates Bajram Abazit nuk i intereson kjo gjë, turp i qoft, ai po sillet si një shef i madhë dhe nuk interesohet për probleme të qytetarëve. Sa i përket ujësjellësit në Makreshë sot me mengjes në ora 08:30 më ka thirr Avdi Beqiri dhe një ditë ma ka thirr Kushtrim Krasniqi pre Makreshit që nuk kanë ujë pothuajse që tre muaj dhe kjo është për keqardhje andaj nuk e di se me çka mirren zyrtarët që janë aty dhe nuk i zgjedh këto probleme. Prandaj Kryesuesja me të drejt po kërkon prej tyre që të mirren më probleme të qytetarëve, ti zgjedhin këto probleme të cilat i kanë qytetarët pasi që për ata paguhen, ju faleminderit.

Behare Jashari pasi përshendeti të pranishmit tha: unë do të flas për ujë, ndriqim dhe rrugën në Mahallen e Romëve, sa i përket ndriqimit nuk kemi që katër muaj, problemi i ujit qytetarët ankohen të unë pasi që jam antare e komitetit, unë këtu disa herë kam fol por nuk kan marrë masa askush, sa i përket rrugës në mahallen e romëve poshtë Shefkije Mehmeti D.SH.P ka premtuar se do ta rregulloj e duhet me permend edhe me lavdëru se kanalizimin e kanë rregullu, andaj i lus organet Komunale që këto probleme ti zgjedhin, ju faleminderit.

Abdyl Gashi tha: e kam përmend disa herë që investimet të cilat kanë ndodhur deri më tani janë rreth 80% jashtë funksionit dhe nuk është fare seriozitetë që të investohet dhe investimet të mos ken mbykqyrje. Çdo investim që nuk planifikohet mirëmbajtja është i dështum ai investim qoft kanalizim, ndriqim, rrugë apo trotuar. Unë si antarë i këtij komiteti kisha kërku që të kemi listen e projekteve të seciles lagje në Komunën tonë, në mënyr që mos të ndodhë që në një vendbanim ti kemi të gjitha ndërsa në një vendbanim tjetër të mos kemi asgjë.

Kryesuesja tha: kush është që këto kërkesa të diskutohen në Kuvend.

Aleksander Pavic tha: në fshatin Koretisht 1/3 e ndriqimit publik nuk funksionon.

Pasi nuk pat diskutime tjera aporovohet njëzëri që këto kërkesa të shqyrtohen në Kuvend.


Pika e katërt: Të ndryshme.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falëndëroi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi ne ora 11:20

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Shpresa Kqiku
Kryesuese i Komitetit për Komunitete

